Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel: 383 38 312 309 email: oshp@rks-gov.net

RAPORTI I EKSPERTIT SHQYRTUES

Eksperti Shqyrtues	Data e autorizimit të ekspertit	Date e dorëzimit të raportit	Nr. i lëndës
Burim Zeka	**26.09.2023**	**29.09.2023**	**2023/0728**

BAZA LIGJORE E SHQYRTIMIT

Me datën: 25.09.2023, **OE "TRAFFIKS VA SH.P.K."-** Prishtinë, ka parashtruar ankesë me nr: 2023/0728, kundër anulimit të aktivitetit të prokurimit, lidhur me aktivitetin e prokurimit: **"Furnizim me shenja te trafikut mobil për paralajmërim dhe për ndalje te automjeteve motorike."** me nr. të prokurimit: "214-23-8152-1-2-1", iniciuar nga Autoriteti Kontraktues **(AK) – POLICIA E KOSOVËS**.

Autoriteti kontraktues ka zbatuar procedurë të hapur, kontratë publike kornizë, furnizim, vlera e parashikuar e kontratës: 22,000.00 €.

Fazat e procedurës se prokurimit:

Njoftimi për kontratë.....03.08.2023;

Procesverbali i hapjes së ofertave.....28.08.2023;

Njoftimi mbi vendimin e AK-së.....04.09.2023;

Kërkesa për rishqyrtim 11.09.2023;

Vendimi i AK-së në kërkesë për rishqyrtim.....13.09.2023;

Ankesa ne OSHP.....25.09.2023;

Konform nenit 113, 114 të Ligjit Nr. 04 / L - 042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04 / L - 237, Ligjin 05 / L - 068, dhe Ligjin 05 / L - 092, Eksperti Shqyrtues i ka shqyrtuar pretendimet ankimore të OE ankues.

DISPOZITAT E SHKELURA DHE PRETENDIMET ANKIMORE

Neni 1 i LPP-së

Neni 6 i LPP-së

Neni 7 i LPP-së

Neni 59 i LPP-së

Neni 60 i LPP-së

Neni 62 i LPP-së

Neni 69 i LPP-së

Neni 72 i LPP-së

Neni 43 i Rregullores NR. 001/2022 për Prokurim Publik

1. Operatori Ekonomik TRAFFIKS VA SH.P.K.- është eleminuar pasi nuk i plotsoin specifikat teknike dhe kriteret e kërkuara si në vijim: **Në dosjen e tenderit është kerkuar:** a) *Operatori Ekonomik duhet të ofrojë katalog / broshurë me të cilën është e mundur vlerësimi i specifikave teknike të ofruara, siç kërkohet në specifikimet teknike (Aneksi I).*

Po ashtu te specifikat e detyrueshme është kërkuar: Të gjitha anët e shenjës duhet të përmbajnë tri shenja të ndryshme me nënshkrime të dallueshme siç janë:

- Stop Police (Sipas mostrave)
- Rrezik në rrugë (Sipas mostrave)
- Aksident në rrugë Sipas mostrave)

Ndërsa Operatori Ekonomik katallogun/broshuren të cilën e ka ofruar i mundon shenja: Stop Police (Sipas mostrave) dhe shenja Aksident në rrugë Sipas mostrave)

Po ashtu i mungon edhe pesha e kërkuar Pesha maksimale 7 kg.

Arsyet e eliminimit janë të paqendrushme, ndërsa më poshte do të elaborojmë pretendimit tona në lidhje me këto arsyetime të eliminimit.

Në lidhje me këtë arsye ju sqarojmë se katalogu i prodhuesit është gjeneral dhe nuk përfshin detajet e pajisjeve. Disa prodhues nuk i vendosin të gjitha të dhënat dhe karakteristikat e shenjave apo produkteve, mirëpo ky fakt mund të sqarohet lehtë sipas nenit 59.2 dhe 72 të LPP-së.
Kjo mund të vërehet edhe tek katalogu në faqen Nr.5 pika 3 ku shkruan se teksti në shenja bëhet në bazë të porosive te klienteve.
Kjo mund të vërehet na foton e katalogut të prodhuesit si më poshtë:



Detect language Albanian English Spanish

For street traffic or on site, our folding signs suit almost every application and are custom manufactured to meet your requirements. TrioSign folding signs designed by Nissen are manufactured in a custom-made fashion to meet your requirements. Choose between different sizes, foils, and signs from the various country catalogues

X

English Albanian Spanish

Për trafikun rrugor ose në terren, tabelat tona të palosshme i përshtaten pothuajse çdo aplikacioni dhe janë prodhuar me porosi për të përmbushur kërkesat tuaja. Tabelat e palosshme TrioSign të dizajnuara nga Nissen janë prodhuar në një mënyrë të bërë me porosi për të përmbushur kërkesat tuaja. Zgjidhni midis madhësive, fletëve dhe shenjave të ndryshme nga katalogët e ndryshëm të shteteve

Në foton me sipër është përkthimi ku me ketë vertetohet se teksti i shenjave behet me porosi nga klienti.

Poashtu edhe sa i përket peshës së kërkuar maksimale prej 7 kg, ju sqarojmë se edhe për këtë karakteristikë apo specifikë prodhuesi nuk i vendos dhe nuk i përshkruan në katalog për shkak se shenjat e trafikut kanë dimensione të ndryshme, forma te ndryshme dhe varësisht nga dimensioni i shenjave ndryshon edhe pesha, prandaj në bazë të kërkesave të klientëve punohet madhësia, forma dhe mbi bazen e kerkesave te klienteve vie edhe deri te pesha e shenjave.

Edhe kjo pikë ka mundur të sqarohet përmes kërkesës për sqarime shtes sipas nenit 59.2 dhe 72 të LPP-së, qoftë duke kërkuar sqarime nga ne si operator ekonomik apo edhe nga prodhuesi drejtpërdrejtë.

Në lidhje me këto arsye të eliminimit, ne kemi kërkuar sqarime nga prodhuesi, ku i njëjti ka deklaruar se fotot në katalog janë vetëm foto të produkteve që shërbejnë vetëm për ilustrim, ndërsa produktet që do të prodhohen së pari duhet të miratohen nga ana e klientit dhe prodhimet mund të kryhen sipas specifikimeve të kërkuara nga klienti.

Bashkangjitur keni sqarimin e dt.08.09.2023 nga prodhuesi.

nissen™
ROAD SAFETY SOLUTIONS.

TÜV AUSTRIA

Traffiks va sh.p.k
Radovan zogoviq B1, C3 hyrja 2 Nr. 27
PRISHTINE 10000
KOSOVO

Your message from: -
Your reference: -
Our reference: nfu
Date: 08.09.2023

Declaration

Dear Sirs,

We as, **Adolf Nissen Elektrobau GmbH + Co. KG**, based in 25832 Tonning, Germany, would like to give an official explanation about the procedure of the best sample and order process for the TrioSign 90 with following technical details:

Weight: 5,2 kg

Design approval: before we can start sampling, all designs and technical specifications for the product to be produced must be approved by you. This ensures that we fully understand your requirements and can carry out production according to your specifications.

Contractor Purchase Order: After design approval, it is necessary for you to place a written purchase order with us for the desired quantity of the product to be sampled. The purchase order should contain all relevant details, including quantity, technical requirements.

Only after these two steps have been completed can we plan and execute the sampling according to the agreed terms. Please note that this procedure is designed to ensure a smooth process and to make sure that your order meets the highest quality standards.

nissen™
ROAD SAFETY SOLUTIONS.

The images in our product catalog serve only as sample images to show a possible representation.

Best regards,

Adolf Nissen Elektrobau
GmbH + Co. KG

i.A. Nikolaus Fuchs
Export Sales Manager

Mbi bazën e dëshmive të cekura më lartë, rezulton se ekzaminimi, vlerësimi dhe krahasimi i tenderëve nuk është bërë në harmoni me nenin 59 të LPP-së, duke u diskriminuar ne si kompani e përgjegjshme dhe me çmim më të ulët.

Duke i pasur parasysh të gjitha faktet në lidhje me kronologjinë dhe ecurinë e këtij aktiviteti të prokurimit, rezulton se ky aktivitet i prokurimit është anuluar në kundërshtim me nenin 62 të LPP-së, sepse nuk janë përmbushur asnjëra nga kushtet e parashikuara në këtë dispozitë.

Anulimi i këtij aktiviteti të prokurimit është bërë në kundërshtim edhe me nenin 43.5 dhe 43.7 i Rregullores nr.001/2022 Për Prokurim Publik, sepse ne jemi ofertues i përgjegjshëm dhe i plotësojmë të gjitha kërkesat e FDT-së dhe të njoftimit për kontratë.

Në këtë aktivitet të prokurimit, nuk është respektuar edhe kriteri kryesor për dhënie të kontratës, e që ka qenë tenderi i përgjegjshëm me çmim më të ulët, konform nenit 60 paragrafi 1.1 i LPP-së.

Gjithashtu nuk është respektuar edhe neni i 7 i LPP-së, duke u diskriminuar ne si operator ekonomik, edhe pse i kemi plotësuar të gjitha kërkesat e FTD-së dhe të njoftimit për kontratë, nuk jemi shpallur fitues të këtij tenderi, kurse paragrafi 1 i nenit 7 të LPP-së e parasheh qartë që "*Autoriteti kontraktues do ti trajtoj operatorët ekonomik në mënyrë të barabartë dhe jo-diskriminuese dhe do të veprojë në mënyrë transparente*".

Gjithashtu nuk është marr në konsideratë edhe neni 1 dhe neni 6 i LPP-së, pasi që dihet se qëllimi i këtij ligji është të sigurojë mënyrën më efikase, më transparente dhe më të drejtë të shfrytëzimit të fondeve publike, burimeve publike si dhe të gjitha fondeve dhe burimeve të tjera të autoriteteve kontraktuese në Kosovë, ndërsa në këtë rast është vepruar në kundërshtim me këto dispozita, duke na eliminuar neve si ofertues i përgjegjshëm dhe me çmim më të ulët.

Duke u bazuar në të gjitha dëshmitë dhe faktet të cilat u cekën më lartë, kërkojmë nga ju si autoritet kontraktues që të nxjerrni:

VENDIM

APROVOHET, si e bazuar kërkesa për rishqyrtim e OE **Traffiks va " sh.p.k.**

ANULOHET njoftimi mbi vendimin (B58) për anulim të aktivitetit të prokurimit dhe lënda të kthehet në
RIVLERSIM dhe gjatë rishqyrtiit, ekzaminimit, vlersimi dhe krahasimi i ofertave të bëhët në harmoni me kërkesat e dosjes së tenderit, njoftimit për kontratë dhe konform dispozitave të LPP-së.

Nëse nuk merren parasysh faktet tona, ne jemi të detyruar të vazhdojmë procedurën ligjore në institucionet tjera kompetente

Pretendimet ankimore te parashtruara ne ankesën e deponuar ne OSHP, janë të njëjta.

KRITERET PËR VLERËSIM

Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale	9.1 & 9.2	**a) Operatori Ekonomik duhet të ofrojë katalog / broshurë me të cilën është e mundur vlerësimi i specifikave teknike të ofruara, siç kërkohet në specifikimet teknike (Aneksi 1).**	**a) Katalogë/ broshurë nga prodhuesi me përshkrime të specifikacioneve teknike siç kërkohet në specifikacionin teknik (Aneksi 1).**

RAPORTI I KOMISIONI VLERËSUES

DEKLARATË

[të deklarohet komisioni vlerësues mbi arsyet që e mbështesin këtë rekomandim]

Komisioni i vlerësimit pas ekzaminimit, vlerësimit dhe krahasimit të ofertave për këtë aktivitet të prokurimit, konstatojmë se për këtë projekt janë pranuar tri (3) oferta. Komisioni vlerësues rekomandon si në vijim: ofertat janë të pa përgjegjshëme pasi nuk i plotsoin specifikat teknike dhe kriteret e kërkuara në dosje të tenderit dhe në njoftim për kontratë. Andaj komisioni i vlersimit rekomandon që të anulohet ky aktivitet i prokurimit.

1.	. Limit L & B SH.P.K. 810593617	**Operatori Ekonomik Limit L & B SH.P.K.**- është eleminuar pasi nuk i plotsoin specifikat teknike dhe kriteret e kërkuara si në vijim: **Në dosjen e tenderit është kerkuar: a)** ***Operatori Ekonomik duhet të ofrojë katalog / broshurë me të cilën është e mundur vlerësimi i specifikave teknike të ofruara, siç kërkohet në specifikimet teknike (Aneksi 1).*** **Ndërsa Operatori Ekonomik katallogun/broshuren te cilin e ka ofruar janë shenjat e trafikut mirëpo produktin të cilin ne e kemi kerkuar nuk është në katallog fare.**
2.	TIC LOG SH.P.K. 810496118	**Operatori Ekonomik TIC LOG SH.P.K.**- është eleminuar pasi nuk i plotsoin specifikat teknike dhe kriteret e kërkuara si në vijim: **Në dosjen e tenderit është kerkuar: a)** ***Operatori Ekonomik duhet të ofrojë katalog / broshurë me të cilën është e mundur vlerësimi i specifikave teknike të ofruara, siç kërkohet në specifikimet teknike (Aneksi 1).*** **Ndërsa Operatori Ekonomik katallogun/broshuren te cilin e ka ofruar ka nderhyr (ka modifikuar) ne katallogun/broshuren e prodhuesit, pasi që te lista e çmimeve ka ofertuar me prodhues (Quanzhou Dingfei Reflective Material cp., Ltd-China.) dhe OE e ka vendos edhe llogon e vetë ne kete broshur do të thot ka bërë modifikim të katallogut/broshurës.** **Po ashtu është kërkuar: 2. Çertifikata e TVSH-se (për Operatoret Ekonomik vendor) – Ndërsa Operatori Ekonomik nuk ka ofruar fare TVSH, arsyeja pse nuk është kërkuar sqarim sipas nenit 72 pasi që nuk na krijon prap rezultat pozitivë.**
3.	TRAFFIKS VA SH.P.K. 811582635	**Operatori Ekonomik TRAFFIKS VA SH.P.K.**- është eleminuar pasi nuk i plotsoin specifikat teknike dhe kriteret e kërkuara si në vijim: **Në dosjen e tenderit është kerkuar: a)** ***Operatori Ekonomik duhet të ofrojë katalog / broshurë me të cilën është e mundur vlerësimi i specifikave teknike të ofruara, siç kërkohet në specifikimet teknike (Aneksi 1).*** **Po ashtu te specifikat e detyrueshme është kërkuar:** Të gjitha anët e shenjës duhet të përmbajnë tri shenja

		të ndryshme me nënshkrime të dallueshme siç janë: • Stop Police (Sipas mostrave) • Rrezik në rrugë (Sipas mostrave) • Aksident në rrugë Sipas mostrave) **Ndërsa Operatori Ekonomik katallogun/broshuren të cilën e ka ofruar i mundon shenja:** Stop Police (Sipas mostrave) dhe shenja Aksident në rrugë Sipas mostrave) Po ashtu i mungon edhe pesha e kërkuar Pesha maksimale 7 kg.

INFORMACIONET SHTESË TË MARRA ME ANË TË SQARIME TË KËRKUARA NGA EKSPERTI SHQYRTUES/TEKNIK

N/A

VLERËSIMI SIPAS NENIT 4.1.26 TË LPP

N/A

VENDIMET E MËPARSHME TË OSHP LIDHUR ME RASTET E NGJASHME

N/A

ARSYETIMI PËR DEVIJIM NGA PRAKTIKA E MËPARSHME

PËRGJIGJE NË PRETENDIMET ANKIMORE TË OE ANKUES - **TRAFFIKS VA SH.P.K.**

Përgjigje në Pretendimin nr.1

Lidhur me pretendimin e OE ankues qe ka te beje me kërkesat teknike & profesionale eksperti shqyrtues sqaron se me kërkesat e FDT 9.1 & 9.2 është kërkuar:

a) Operatori Ekonomik duhet të ofrojë katalog / broshurë me të cilën është e mundur vlerësimi i specifikave teknike të ofruara, siç kërkohet në specifikimet teknike (Aneksi 1).

a) Katalogë/ broshurë nga prodhuesi me përshkrime të specifikacioneve teknike siç kërkohet në specifikacionin teknik (Aneksi 1).

Ne baze te specifikimit teknik është kërkuar

Të ketë efektin e lotit (lotues) për shkak të parandalimit të papastërtive.

Të gjitha anët e shenjës duhet të përmbajnë tri shenja të ndryshme me nënshkrime të dallueshme siç janë:

Stop Police (Sipas mostrave)

Rrezik në rrugë (Sipas mostrave)

Aksident në rrugë Sipas mostrave)

Shenjat duhet të jenë të punuara sipas cilësisë se bashkimit evropian.

Shenja e trafikut duhet te jetë 90 cm, ndërsa se bashku me kornize nuk duhet ta kalojnë me shume se 110 cm. Pesha maksimale 7 kg.

Operatori Ekonomik ka dorëzuar me ofertë katalogun gjeneral të prodhuesit në të cilin nuk janë te përfshira detajet e kërkuara me dosjen e tenderit dhe specifikimin teknik. Ne kërkesën për rishqyrtim dhe ankesën ne OSHP OE ankues ka dërguar një dokument nga prodhuesi ne te cilin prodhuesi sqaron se vetëm pas dërgesës se urdhër blerjes mund te ekzekutojnë porosinë sipas kërkesës se blerësit.

Eksperti shqyrtues vlerëson se përkundër faktit se AK-ja ka kërkuar qe OE-te te dorëzojnë "**Katalogë/ broshurë nga prodhuesi me përshkrime të specifikacioneve teknike siç kërkohet në specifikacionin teknik"** i njëjti nuk i ka ofruar. Gjatë kërkesës për rishqyrtim OE ankues sipas shkresës së prodhuesit i cili ka deklaruar se duhet të **"dërgohet një urdhër blerje me shkrim nga kontraktori"** në mënyrë që të ekzekutojnë porosinë sipas kërkesave, pra nuk ka ofruar mallrat sipas kërkesave.

Prandaj eksperti shqyrtues vlerëson se AK-ja gjate vlerësimit te ofertave ka vepruar ne përputhje me **Neni59 Ekzaminimi,VlerësimidheKrahasimiiTenderëve paragrafi 4.** Autoriteti kontraktues dotëkonsiderojënjëtendersi tëpërgjegjshëmvetëmnësetenderinë fjalëështë nëpërputhshmërimetëgjithakërkesateparashtruaranë njoftimine kontratësdhenë dosjenetenderit.

Poashtu AK-ja ka vepruar në përputhje me RRUOPP neni 39.8 kur nuk ka kërkuar sqarime shtesë nga OE ankues.

Është dorëzuar katalogu por mungon specifikacioni teknik për mallrat e ofruara	Refuzo tenderin pa kërkuar informacion të mëtejshëm	69

Eksperti shqyrtues vlerëson se pretendimi ankimor i OE ankues **nuk është i bazuar.**

REKOMANDIMI I EKSPERTIT SHQYRTUES

Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues refuzohet si e pabazuar dhe të mbetet në fuqi vendimi i AK.

Raporti i ekspertizës ti dorëzohet:

- Autoritetit Kontraktues – **POLICIA E KOSOVËS**
- Panelit Shqyrtues – OSHP
- OE ankues – **TRAFFIKS VA SH.P.K.**

REPUBLIKA E KOSOVËS ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKI PRISHTINË/A REPUBLIKA KOSOVA

Burim Zeka